



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 127, Datë 07.04.2023**

**MBI**

**MIRATIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË TREGTIMIT NË BURSËN SHQIPTARE TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 18 pika 1, gërma “a” dhe “dh”; 19 gërma “a”, 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar si dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.06.2016; VKM-së nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, e ndryshuar, si dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1188/1 prot., datë 05.04.2023, i përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, bordi i ERE-s vendosi të miratojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, ndërsa me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.03.2023, janë miratuar disa shtesa në rregullat e tregut të energjisë elektrike, konkretisht anekset nr. 1 deri në 7.
- Shoqëria ALPEX sh.a., me shkresën nr. 111 prot, datë 05.04.2023, protokolluar në ERE me nr. 1188 prot., datë 05.04.2023, ka paraqitur propozimin e saj mbi Ditën e Fillimit të tregtimit të tregut të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE).
- Në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike janë anëtarësuar shoqëritë publike të sektorit të energjisë, të tilla si, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.
- Rezulton se shoqëria ALPEX sh.a. ka kryer disa periudha testimi nga muaji Janar 2023 deri më datë 20 Mars 2023 për të gjithë Anëtarët potencialë të Bursës dhe deri më datë 05.04.2023 ka kryer të gjitha testimet në Platformën e Tregtimit si dhe ka testuar Platformën e Tregtimit, Klerimit dhe Menaxhimit të Riskut me Anëtarët e Bursës dhe Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit për të gjitha transaksionet e parashikuara.
- Shoqëria ALPEX sh.a., garanton që ka mjaftueshëm Anëtarë Burse dhe likuiditetin e nevojshëm për të filluar tregtimin, në mënyrë që çmimet të reflektojnë sinjalet e tregut dhe të prodhohen çmime për çdo Njësi Kohore Tregu, po ashtu ka të garantuar suportin e Ofruesit të Shërbimit, në mënyrë që fillimi i operimit të jetë sa më i sigurtë, si dhe për sa i përket fazës

fillestare të operimit të BSHE, Platforma e Tregtimit, Klerimit dhe Menaxhimit të Riskut ka të implementuar vetëm Tregun e Ditës në Avancë dhe Urdhërporositë e Thjeshta.

- Rezulton se Grupi i Punës dhe shoqëria ALPEX sh.a., kanë vlerësuar se kërkesat e nevojshme për fillimin e operimit të Tregut të Ditës në Avancë janë përmbushur dhe janë në përputhje me paragrafin K.1.3.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, ku citohet se “E para Njësi Kohore e Tregut për qëllim të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike do të fillojë në Kohën e Përcaktuar”.
- Shoqëria ALPEX sh.a. ka propozuar që dita e fillimit të Tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë të jetë Njësia Kohore e Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.04.2023.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e Njesisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.04.2023, si dita e fillimit të tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike - Alpex sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e tjera të interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**